



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 121 dt.22.09.1995

PER
BERJE PROPOZIM PER AKORDIM PENSIONI TE POSACEM
SHTETEROR PER FEMIJET E DESHMORIT PELLUMB TAHIRI.

Këshilli i Bashkisë Tiranë, në mbledhjen e dt.22.09.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Organizimit për bërje propozimi Këshillit të Ministrave që fëmijët të mitur të dëshmorit Pëllumb Tahiri ti akordohet pension i posaçëm shtetëror në masën që parashikon vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave.

Vëren se :

Z.Pëllumb Tahiri është shpallur dëshmor i atdheut u vra në shkollën e bashkuar me 22 shkurt 1992 nga grupet ushtarake të diktaturës komuniste për shkak të veprimtarisë së tij për fitoren e demokracisë, duke lënë bashkëshorten e re dhe tri fëmijë të vegjël (më i madhi 11 vjeç).

Pensioni që u është i lidhur fëmijëve (nga 1.200 lekë seicili) si dhe rroga e gruas nënës së fëmijëve e cila punon sanitare në spitalin kirurgjikal të Tiranës (rreth 2.500 lekë) nuk mundet të plotësojë kërkesat për rritjen e edukimin e fëmijëve.

Në këto kushte Këshilli i Bashkisë së Tiranës mbështetur në pikën.21, të nenit.14, të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” dhe në bazë të VKM Nr.272, dt.21.06.1994,

VENDOSI

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave që tri fëmijëve të mitur të dëshmorit të atdheut Z.Pëllumb Tahiri ti akordojë një pension të posaçëm shtetëror në masën 8.800 lekë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA